

**Deklaratë miratimi për përdorimin e fotografive dhe incizimeve të filmit.**

Me nënshkrimin tim unë e jap pëlqimin tim që punonjës të Fondacionit të leximit mund të publikojnë dhe përhapen fotografi dhe incizime filmi nga unë respektivisht nga personi i mitur/personi nën përkujdesje ligjore, të cilin unë përfaqësoj, të bëra

---

**më datë**

**gjatë terminit për shtypin me rast të respektivisht gjatë uorkshopit/seminarit me titullin**

---

**në**

---

**institucioni, adresa**

në mediat e poshtëshënuara në lidhje me raportimin për klubet e leximit respektivisht media.labs në kuadrin e programit të promovimit të BMBF-së [Ministrisë Federale për Arsim dhe Kërkim] „Kulturë bën të fortë. Aleanca për arsim“ si dhe për punën reklamuese të të gjithë partnerëve pjesëmarrës (Ministrisë Federale për Arsim dhe Kërkim, mbartës të projekteve DLR) për këtë projekt.

**Të dhënat personale:**

---

**Mbiemri, emri i fëmijës**

**O Me këtë unë e jap pëlqimin tim që fotografitë dhe incizimet e filmit të bëra nga aktiviteti i lartpërmendur mund të përdoren nga Fondacioni i leximit dhe partnerët e tij të lartpërmendur në mediat e shtypit (p.sh. broshura, fletëpalosje, postera, raporte biznesi), në internet (p.sh. faqa e internetit, platforma, media sociale) dhe në intranet si dhe nga media të tjera (p.sh. në TV, shtypin ditor, magazina, paraqitje në internet dhe kanale sociale të mediave publike).**

Unë mund ta prapësoj pëlqimin tim në çdo kohë plotësisht ose pjesërisht. Prapësimi vlen vetëm me efekt për të ardhmen. Media tashmë të prodhuara të shtypit dhe digjitale janë përjashtuar nga prapësimi deri në botimin e ri.

Prapësimi duhet t'i drejtohet këtij vendi: *Stiftung Lesen, Römerwall 40, 55131 Mainz.*

Unë e kam të qartë që kjo deklaratë pëlqimi bëhet vullnetarisht dhe nuk krijohet asnjë disavantazh, nëse unë nuk e jap pëlqimin tim. Unë i kam marrë në dijeni informacionet që i janë bashkëngjitur këtij pëlqimi dhe di për cilat qëllime incizimet personale do të përdoren.

---

Vendi + data e incizimeve të fotografive/filmit, nënshkrimi

---

në rast të të miturve respektivisht të personit në përkujdesjen ligjore nënshkrimi i mbajtësit të përgjegjës së respektivisht të kujdestarit



## Informacion për publikimin re të dhënave personale, fotografive ose filmave në internet

Ju lutemi kini parasysh që me përdorimin e planifikuar në faqet e internetit dhe në mediat sociale ekziston mundësia e aksesit botëror në imazhet respektivisht e thirrjes së të dhënave dhe imazheve të vendosura. Këtu mund të përfshihen edhe akseset nga vende, në të cilat nuk ekziston asnjë standard ose asnjë standard të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave. Fondacioni i leximit nuk mund të ndikojë i as për akseset në këto të dhëna nëpërmjet internetit, as për përdorimin e këtyre të dhënave dhe atëherë as nuk mund të marrë përsipër një garanci për respektimin e mbrojtjes së të dhënave.

Me makina të përshtatshme të kërkimit mund të gjenden të dhëna personale në internet dhe mund të identifikohen eventualisht gjithashtu personat e paraqitur në imazhe. Me këtë ekziston edhe mundësia që me bashkimin e këtyre të dhënave dhe informacioneve me të dhëna të tjera ekzistuese në internet të krijohen profile të personalitetit dhe të shfrytëzohen mundësi të tjera shtesë të përdorimit, p.sh. për qëllimin e reklamës. Për shkak të mundësive të aksesit në të gjithë botën dhe të ruajtjes së të dhënave nga organe ose persona të tjerë, në rast të prapësimit të pëlqimit dhe me gjithë heqjen e të dhënave dhe imazheve tuaja nga faqja jonë e internetit, nuk mund të përjashtohet një përdorim i mëtejshëm nga organe ose persona të tjerë ose të gjetjes nëpërmjet funksioneve të arshivimit të makinave të kërkimit.

## Detyrime të tjera të informacionit sipas nenit 13 EU-DS-GVO (Dekreti Bazë i Be-së për Mbrojtjen e të Dhënave )

Ky udhëzim për mbrojtjen e të dhënave duhet t'ju informojë për cilat qëllime Fondacioni i leximit (në vijim i quajtur „ne“ ose „na“) i përpunon të dhënat tuaja personale. Lidhur me këtë të dhëna personale janë të gjitha informacionet të cilat i referohen personit tuaj. Informacionet që vijojnë duhet t'ju ndihmojnë që ta kuptoni përpunimin e të dhënave tuaja personale dhe duhet të kujdesin kështu për transparencë.

Fotografit dhe incizimet e bëra të filmit di dhe mbiemri dhe emri të personit të pasqyruar përdoren për mediat e përmendura në pëlqim në lidhje me raportimin për ditën botërore të librit si dhe për punën reklamuese të Fondacionit të leximit dhe të partnerëve të tij të projekteve (këtu: Shoqata gjermane e tregimit të librit, Posta Gjermane DHL Group, shtëpia botuese cbj, ZDF [Televizioni i Dytë Gjerman])

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave tuaja personale për qëllimet e lartpërmendura është kjo deklaratë pëlqimi. Dhënia e pëlqimit nga ju bëhet vullnetarisht. Kjo do të thotë se nuk jeni i detyruar që të na vini në dispozicion të dhënat tuaja personale. Në rast se ju nuk dëshironi të jepni këtë deklaratë pëlqimi, ne konstatojmë shprehimisht që kjo për ju nuk është e lidhur me asnjë disavantazh.

Nuk do të bëhet asnjë vendimmarrje automatike, e cila bazohet vetëm në përpunimin e automatizuar, duke përfshirë profilizimin, dhe krijon një efekt ligjor ose ju cenon në një mënyrë të ngjashme.

Incizimet e bëra do të ruhen për aq kohë si Fondacioni i leximit ka një interes të arsyeshëm në përdorimin e këtyre ose derisa persona të prekur e kundërshtojnë përdorimin e incizimeve. Prapësimi i pëlqimit të bëhet me efekt për të ardhmen. Media tashmë të prodhuara të shtypit dhe digjitale janë përjashtuar nga prapësimi deri në botimin e ri.



Përveç kësaj bëhet një fshirje atëherë, kur ekziston njëri prej kushteve të nenit 17 par. 1 DSGVO dhe nëse kësaj nuk e kundërshton asnjë detyrim ligjor të ruajtjes.

Sipas dispozitave të Dekretit Bazë të Be-së për Mbrojtjen e të Dhënave ju mund t'i kërkonit këto të drejtat tuaja ndaj nesh:

- të drejtën për njoftim
- të drejtën për korrigjim
- të drejtën për kufizimin e përpunimit
- të drejtën për fshirje / të drejtën për harresën
- të drejtën për transmetueshmërinë e të dhënave

Përveç kësaj ju keni të drejtë që ta prapësoni këtë pëlqim në çdo kohë. Nëpërmjet prapësimit të miratimit nuk preket legjitimiteti i përpunimit, të dhënë për shkak të miratimit deri në prapësim.

Për të kërkuar njërën prej të drejtave të lartpërmendura ju mund të na drejtoheni në çdo kohë:  
Andrea Bartl, kaufm. Geschäftsführung [drejtoria tregtare], Römerwall 40, 55131 Mainz, përmes e-mailit:  
[andrea.bartl@stiftunglesen.de](mailto:andrea.bartl@stiftunglesen.de).

Nëse ju jeni i mendimit që ne i përpunojmë të dhëna tuaja personale në mënyrë jo të lejueshme, atëherë kontaktoni, ju lutemi, të ngarkuarin tonë për mbrojtjen e të dhënave. Ai mund të arrihet nën të dhënat e kontaktit që vijojnë: SPIE GmbH, në dorë të zotit Dr. Anton Peuser, Lyoner Straße 9, 60528 Frankfurt am Main.

Përveç kësaj ju keni të drejtë që t'i drejtoheni autoritetit të mbrojtjes së të dhënave. Autoriteti kompetent mbikëqyrës është: Der Landesbeauftragte für den Datenschutz und die Informationsfreiheit Rheinland-Pfalz, Postfach 30 40, 55020 Mainz. [I ngarkuari i landit për mbrojtjen e të dhënave dhe lirinë e informacionit Rheinland-Pfalz, Kutia postare 30 40, 55020 Mainz]

